



# MINUTAT E MBLEDHJES

19 PRILL 2023

ORA 11:00

SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI

## TË PRANISHMIT

---

**Z. Genci Tërpo**, Drejtues i Sekretariatit Kombëtar EITI

**Znj. Anila Hajnaj**, Drejtues i Qendrës Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim

**Z. Sami Nezaj**, Drejtues i Qendrës për Transparencë dhe Informim Falas

**Znj. Ola Mitre**, Drejtues i Shoqatës së Grave për Mbrojtjen e Burimeve Natyrore

**Z. Lorenc Gordani**, Drejtues i Qendrës Shqiptare për të Drejtën Ndërkombëtare

**Z. Dritan Dervishaj**, Menaxher i mjedisit dhe guroveve

**Z. Bilal Koçi**, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Minerale

**Znj. Mariola Kito**, Menaxher i Burimeve Njerëzore & Administrimit dhe Pajtueshmërisë

**Z. Kushtrim Simoni**, Shoqëri Civile

**Z. Lluka Gjergo**, Koordinator EITI Albania

**Z. Ardit Kamberi**, Koordinator EITI

**Znj. Selma Ago**, Shef Sektori EITI Albania

**Znj. Emiliana Kola**, Specialiste e Burimeve Njerëzore EITI Albania



**Znj. Majlinda Balla**, Specialiste Finance EITI Albania

**Znj. Kristiana Kërthi**, Specialist EITI

**Znj. Xhorxhina Çota**, Specialist EITI

## FOTO NGA MBLEDHJA

---



### **Çështjet e trajtuara në mbledhjen me MSG-në e zhvilluar në orën 11:00, më 19 Prill 2023:**

- 1. Diskutim dhe/ose miratim i ToRs për Fushatën e Komunikimit 2023-2025;*
- 2. Diskutim dhe/ose miratim i ToRs për kontraktimin e një Konsulenti Prokurimesh;*
- 3. Diskutim dhe/ose miratim i ToRs për kontraktimin e një Konsulenti për menaxhimin financiar.*

**Znj. Emiliana Kola:** Përshëndetje të gjithëve. Mendoj që të fillojmë, nëse ka të tjerë mund të na bashkohen ndërkohë.

**Z. Genci Tërpo:** Unë sapo fola me zëvendësministrin Z. Bejtja, ai po mundohet të hyjë në takim. Ok, gjithsesi ne mund të vijojmë. Faleminderit për pjesëmarrjen. Mbledhja e ditës së sotme ka të bëjë me diskutimin për miratimin e Termave të Referencës të tre komponentëve të projektit të ardhshëm që ne kemi. Në rastin konkret, ai dhe më i rëndësishëmi, është kontraktimi i një konsulenti për financën dhe një për prokurimin për Sekretariatit Nisma për Transparencë në Industrinë nxjerrëse. Ne kemi përdorur të njëjtin model që është përdorur dhe më parë të Termave të Referencës për përzgjedhjen e këtyre dy konsulentëve, terma të cilat besoj ju i keni parë dhe më parë. Të vetmet ndryshime janë te periudha e viteve kur do të zhvillohet projekti, te kriteret e përzgjedhjes së konsulentëve, standardet deri diku, pra janë kritere të cilat përdoren përgjithsisht dhe nga Banka Botërore në projekte të tjera. Ju kërkojmë ndjesë që ja u dërguam në një moment pak të vonë, por kjo lidhet me problemet e linjës së internetit që kemi patur këto dy ditë në zyrën tonë. Gjithashtu, duke qenë se muaji prill është goxha i ngjeshur me pushime, na e ka vështirësuar pak dhe zhvillimin e aktiviteteve të punës. Gjithsesi, siç thashë Termat e Referencës janë standarde siç kanë qenë dhe më parë, terma të cilat i keni parë dhe i keni miratuar, pra nuk po sjellim ndonjë risi në aspektin e përzgjedhjes së dy konsulentëve, qoftë të konsulentit financiar, qoftë të konsulentit të prokurimit. Keni ndonjë mendim?

**Znj. Mariola Kito:** Kam një pyetje duke qenë se s'kam qenë e përfshirë më parë në mënyrën e selektimit. Aktualisht kam hapur draftin për konsulentin e prokurimit dhe po lexoj "Single Source Selection". Si është më konkretisht procedura e selektimit të konsulentëve?

**Z. Genci Tërpo:** Ideja është kjo. Jemi në fazën që këto terma trajtohen njëherë nga ju. Natyrisht që procedura e selektimit është e lidhur shumë dhe me atë që Banka do të na kërkojë, por duhet të kemi parasysh që po diskutojmë për të filluar procedurat e prokurimit në një kohë kur akoma nuk kemi fonde për sa i përket kësaj çështje, por për shkak të detyrimit për të realizuar aktivitete brenda një kohë relativisht të shkurtër, jemi detyruar që këta dy konsulentë t'i kemi të paktën disa ditë përpara fillimit të procedurave të tjera që ne kemi, sepse të dy këta komponentë janë të rëndësishëm për ta lehtësuar procedurën që Sekretariatit do ndërmarrë për sa i përket përzgjedhjes së konsulentëve, apo kompanive, apo ekspertëve në të ardhmen, në aktivitetet që ne kemi. Si rregull shpallet në faqen e internetit të Sekretariatit Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe u lihet një afat i caktuar personave që i plotësojnë kriteret, për të paraqitur shprehjen e interesit. Më pas bëhet përzgjedhja e tyre në bazë të një komisioni prokurimi që ne kemi. Kjo do të zbatohet dhe për dy komponentët në fjalë. Në bashkëpunim dhe me Bankën Botërore, për shkak të emergjencave, kjo procedurë edhe mund të ndryshojë, gjithmonë duke marrë konfirmim nga Banka Botërore, pasi prej saj udhëzohemi dhe drejtohem për sa i përket aktiviteteve përkatëse për të përzgjedhur qoftë dhe konsulentët në fjalë. Pra, janë terma standarde që Banka Botërore përdor për përzgjedhjen e konsulentëve, nuk është se ne kemi bërë ndonjë ndryshim, thjesht i kemi pershtatur në raport me termin "sekretariat", pra janë pothuajse të njëjtat terma që përdoren në të gjitha projektet që ka Banka Botërore në Republikën e Shqipërisë.

**Znj. Mariola Kito:** Po një integriti check ose background check për personat e selektuar bëhet? Është praktikë nga ana e sekretariatit ose e Bankes Botërore? Pra, bëhet një background i eksperiencës, shkollimit për personin e selektuar?

**Z. Genci Tërpo:** Po patjetër. Të paktën këto dy elemente i duam të jenë në nivel shumë të mirë, sepse këta e lehtësojnë në njëfarë formë dhe punën e sekretariatit dhe minimizojnë çdo lloj gabimi të mundshëm që

mund të presupozohet të bëhet. Pra janë një filtër i posatshtëm që ndihmon jashtëzakonisht shumë për sa i përket procedurave, qoftë financiare, qoftë atyre të prokurimit. Natyrisht që në interesin tonë është që të kemi persona që janë shumë të mirë në këtë fushë, pasi kanë goxha punë për të bërë, edhe në ndihemi komodë kur kemi persona të aftë për sa i përket kësaj gjëje. Dhe po të shikojmë te drafti, te pjesa qualifications janë dhe kualifikimet që kërkohen për secilin konsulent që do të përzgjidhet. Pra janë terma standarde, nuk është se kemi bërë ndryshime. Janë ato që kemi patur dhe në periudhën gjatë viteve 2019-2020 apo viteve 2017-2018, janë të njëjtat terma. Sigurisht, siç thashë kjo është një procedurë që duhet të fillojë më parë se procedurat e tjera për të patur dhe kohën e nevojshme që të dy ekspertët të jenë në ndihmë të sekretariatit për vijimin e procedurave të tjera. Keni ndonjë koment për sa i përket kësaj çështje?

**Znj. Anila Hajnaj:** Problemi është që në përgjithësi, pavarësisht se ata mund të marrin disa njohuri, nuk kanë njohuri të thelluara dhe të paktën për mua kjo ka qenë gjithnjë problem dhe mendoj që duhet parë me kujdes.

**Z. Genci Tërpo:** Atëherë që ta kuptojmë dhe njëherë, të dy konsulentët në fjalë duhet të kenë njohuri për sa i përket procedurave të Bankës, që do të thotë se në momentin që mbarojnë punë me EITI-n mund të shkojnë tek uji, te raketat, pra nuk kërkohet ndonjë element shumë specifik në lidhje me njohjen e fushës në fjalë, por njohjes së procedurës së Bankës, e cila është standarde dhe përcakton rregulla të posatshme lidhur me menaxhimin financiar apo me menaxhimin në fushën e prokurimit të një çështjeje të caktuar dhe praktika ka treguar që konsulentët që ne kemi patur kanë qenë në ndihmë të theksuar të Sekretariatit. Natyrisht që me Bankën Botërore punojnë një numër i kufizuar njerëzish, nuk është se janë me mijëra njerëz që operojnë në këtë lloj fushe, megjithatë njohja e procedurave të Bankës Botërore besoj që është një mundësi për të gjithë ata që duan të punojnë në këtë fushë. Procedura e prokurimit është një procedurë për ndjekjen e një manuali të caktuar për sa i përket Bankës dhe siç ju thashë janë terma që ne i kemi trajtuar po njësoj si para dy viteve në lidhje me përzgjedhjen e dy konsulentëve. Pra duke i marrë me radhë termat për sa i përket përzgjedhjes së konsulentit të menaxhimit financiar. Po t'i referohemi pjesës së tretë, Scope of the Eork, e gjitha në total përfshin veprimtarinë e konsulentit të menaxhimit financiar në raport me zhvillimin e projektit të ardhshëm të Sekretariatit, për implementimin e dokumentacionit, veprimeve racionale për sa i përket financës, në përputhje me standardin që ka vendosur Banka Botërore në lidhje me rregullat financiare, kontrollit për të garantuar që projekti do të jetë i sigurt në cdo aspekt për sa i përket çështjes financiare. Pika e dytë është menaxhimi financiar në terma afatgjatë dhe afatshkurtër në lidhje me procesin e planifikimit duke asistuar drejtuesin e Sekretariatit si dhe stafin për zhvillimin financiar dhe planifikimin e projektit. Zhvillimi i veprimeve financiare përmes një plani performance për aktivitetet e projektit në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore është një element tjetër që ka konsulenti financiar. Shikimi, rishikimi, verifikimi, procesi i aprovimit të të gjitha kërkesave për pagesa për zhvillimin e aktivitetit të projekteve që lidhen me kontraktoret apo konsulentet është një element tjetër i punës së këtij personi që do të përzgjidhet. Gjithashtu, të sigurojë që pagesat që do të bëhen nga Sekretariati të jenë të duhurat, të aplikuar në kohë dhe të gjitha burimet financiare që janë të disponueshme për projektin qoftë në aspektin e pagesave të kontratave, funksionimin, bashkëpunimin me njësinë e Prokurimit dhe me koordinatorin e kontratës përkatëse. Detyrë tjetër është të asistojë EITI-n në të gjithë procesin e menaxhimit financiar për projektin duke garantuar që transaksionet të jenë të specifikuar, pra të kenë një sistem të rekordeve, në rastin konkret në kohë dhe të jenë bërë në mënyrën e duhur për të verifikuar efektshmërinë dhe përputhjen e të gjitha transaksioneve dhe të sigurojë që ka një situatë rekordesh të

përditësuara për sa i përket çështjes financiare që janë të rëndësishme për garantimin dhe funksionimin e projektit dhe të njësisë së Menaxhimit për sa i përket raporteve përkatëse. Ky konsulent përgatit dhe dërgon për aprovim nga bordi financiar raportin e buxhetit, parashikimet financiare, pagesat në përputhje dhe me kurset e këmbimit dhe të gjitha çështjet që lidhen me aspektin financiar. Gjithashtu dhe raportet në lidhje me kërkesat që kërkon Banka Botërore, EITI, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave. Përgatit në kohë raportet periodike për çështjet financiare, raportet vjetore financiare, deklaratat financiare, dhe të gjitha raportet e tjera që kërkohen nga Sekretariati. Procesin e tërheqjeve të aplikimeve në Bankë duke garantuar të gjitha kërkesat statutoare në përputhje me kriteret që percakton Banka Botërore dhe ato që percakton auditin. Përgatit raporte 4 mujore dhe raporte progresi vjeçare, përgatit informacione periodike për njësinë e Prokurimit të projektit, për përgatitjen e kontratës për pagesat dhe supervizon komformitetin me kërkesat që parashikon projekti dhe buxheti. Rishikon aspektet financiare, procedurën e tenderimit dhe përgatit komente në kohë për njësinë e Prokurimit për dërgimet pranë Bankës Botërore, informon dhe këshillon EITI-n për çështje që lidhen me konceptet e taksimit lokal të bankës dhe për kriteret apo rregullat që afektojnë aktivitetin financiar. Ndihton punën e auditorëve të pavarur, ndihton EITI-n për sa i përket përgatitjes së dokumentacionit të auditit, jep kontribut për sa i përket raporteve që përcillen nga auditorët drejt EITI-t, duke përfshirë kërkesat e auditimit dhe letrat e menaxhimit, merr pjesë dhe përfshihet në mënyrë aktive në trajnime, ëorkshop, seminare që lidhen me komponentët e projektit dhe implementimin e kategorive të caktuara të saj, gjithashtu performon në çështje të caktuara apo aktivitete të tjera që i kërkohen nga Sekretariati, apo drejtuesi i Sekretariatit, apo koordinatori i kontratës. Pra këto janë detyrat që ka konsulenti për menaxhimin financiar në këtë veprimtari që do të zhvillohet për implementimin e projekteve që ka EITI në raport me projektet që do të marrë nga ana e Bankës Botërore. Për sa i përket kriterëve, janë të njëjtat që kemi përdorur edhe më parë, standarde lidhur me kualifikimin, shkollimin, me aktivitetin që kanë patur, pra nuk ka ndonjë ndryshim. Keni ndonjë koment? Mendoni se duhet shtuar ndonjë gjë? Këto janë terma standarde që lidhen ngushte me veprimtarinë e Bankës, pra duhet që personat të kenë njohuri, të kenë punuar ose të jenë të informuar për sa i përket çështjes së rregullave financiare që parashikon Banka Botërore. E njëjta gjë është dhe në rastin e konsulentit të prokurimit. Duhet të na shërbejnë, të jenë persona që kanë njohuri, sepse për ne ata janë një ndër filtrat kryesorë dhe një ndër facilitetet më të mëdha që mund të ketë Sekretariati, duke na e bërë punën shumë më të lehtë në vijim për zhvillimin e gjithë procedurave përkatëse. Praktika ka treguar që këta konsulentë kanë qenë shumë korrektë në aktivitetet që ka pasur EITI dhe kanë garantuar zhvillimin në përputhje me kriteret e projektit, gjë që është trajtuar dhe përmes raporteve të auditit që janë bërë në përfundim të çdo projekti, ku i është lehtësuar puna Sekretariatit për sa i përket të dyja procedurave në kuadrin financiar dhe atë të procedurave të prokurimit për zhvillimin e aktiviteteve përkatëse. Mendoni që janë ok? T'i konsiderojmë të miratuara këto terma?

**Z. Sami Neza:** Ok. I miratojmë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Ok.

**Znj. Mariola Kito:** Ok.

**Z. Bilal Koçi:** Dakord.

**Znj. Ola Mitre:** Ok.

**Z. Genci Tërpo:** Ok. Mendoj që jemi ok dhe me pjesën financiare dhe me pjesën e prokurimit. Apo doni që të vijoj me pjesën e prokurimit, të trajtoj të njëjtën gjë?

**Z. Sami Neza:** Unë mendoj që është e mjaftueshme. Kisha vetëm një pyetje. Më herët me sa mbaj mend ekspertët janë zgjedhur nga një listë ekspertësh që kishte Banka Botërore. Tani nuk është apo e kam ngatërruar unë, nuk është e njëjta gjë?

**Znj. Emiliana Kola:** Sami, më heret gjithmonë është bërë procedurë prokurimi po është marrë gjithsesi një mendim nga Banka për të na sugjeruar kur ka mundur ose kur është dashur, profesionistë që kanë punuar me Bankën më parë. Në fakt për sa i perket ekspertit të prokurimeve ka qenë një zonjë që ne e kemi gjetur që në 2014 dhe ajo ka vazhduar për shumë vite. Dmth janë zhvilluar procedurat e prokurimit, por ajo ka vazhduar pas shumë vitesh, ndërkohë që për konsulentin financiar është bërë një procedurë prokurimi e mirëfilltë dhe sigurisht që është marrë dhe mendimi i Bankës në lidhje me personat që kanë punuar me Bankën. Nuk është taksative që ta japë Banka listën dhe ne të zgjedhim nga ata, varet dhe nga personat që marrin pjesë në të. Duhet zgjedhur një procedurë prokurimi normalisht.

**Z. Sami Neza:** Ok. Në rregull.

**Z. Lorenc Gordani:** Kërkoj ndjesë për vonesën. Dokumentet i kemi, procedurat e prokurimit dhe ato fiskale janë standarde kështu që besoj se nuk do të ketë ndonjë problem apo ndonjë ndërhyrje, megjithatë nëse do të kem diçka do t'jua përcjell.

**Z. Genci Tërpo:** Patjetër Lorenc. Le të kalojmë në pikën e dytë ku paraqiten Termat e Referencës për paketën e aktivitetit të komunikimit për periudhën maj 2023 deri në nëntor të vitit 2025, kur është planifikuar të përfundojë dhe projekti. Siç e dini, në projektin e mëparshëm që kishim, EITI ndërmori një fushatë komunikimi për sa i përket çështjeve në lidhje me ndërgjegjësimin qytetar apo ndërgjegjësimin institucional, apo të institucioneve lokale përfshirë dhe kompanitë me të cilat ne operojmë në fushën e industrisë nxjerrëse. Për t'u njohur me veprimtarinë e Sekretariatit dhe punën që kemi bërë, si dhe me realizimin e një plani në të ardhmen për sa i përket aktiviteteve të komunikimit. Periudha që ne realizuam veprimtarinë e komunikimit, siç e dini ka qenë një periudhe e vështirë, periudha e pandemisë. Me gjithë vështirësitë, patëm një mundësi ta zhvillonim, kuptohet një pjesë e aktiviteteve kishin të bënin me publikimin në median e shkruar, atë elektronike apo atë audiovizive që nuk na e vështirësonte pjesën e problematikave që solli pandemia dhe një pjesë kishte të bënte me aktivitete që kërkonin takime nëpër bashkitë apo me grupet e interesit për sa i përket çështjeve të publicitetit të veprimtarisë së Sekretariatit në kuadër të aktiviteteve të ndryshme që ne zhvillonim gjatë periudhës 2019-2020. Megjithatë me gjithë vështirësitë që patëm, aktivitetet e medias u realizuan në kohë dhe në cilësi. U realizua dhe një strategji për sa i përket medias, e lidhur shumë me kushtet konkrete që ne kishim, pandemia. S' dinim kur do të përfundonte, çfarë do të ndodhte, por koha tregoi që situata tashmë është shumë më ndryshe, e qetë të paktën në këtë aspekt. Ne jemi të detyruar të vazhdojmë me aktivitetet e komunikimit që i shërbejnë Sekretariatit në vetvete, grupeve të interesit, procesit të validimit të Shqipërisë lidhur me çështjen EITI dhe ndihmojnë më së miri për ta bërë sa më transparente dhe të prekshme për publikun veprimtarinë e Sekretariatit në raport dhe me zhvillimin e projektit në periudhën maj 2023 deri në fund të vitit 2025. Jemi fokusuar në elementë të rëndësishëm që lidhen me veprimtarinë e Sekretariatit në raport me strategjinë për komunikimin e sekretariatit. Është një veprimtari që do të zgjasë për një periudhe gati 2 vjeçare me aktivitete të caktuara që do të ndihmojnë veprimtarinë e Sekretariatit, qoftë në aktivitete të ndryshme për facilitimin e tyre, qoftë në bërjen publike të punës/veprimtarisë së Sekretariatit në raport me shoqërinë, me grupet e interesit, paralelisht dhe me organizatat apo institucionet ndërkombëtare, të cilat janë një gur themeli i rëndësishëm në bashkëpunimin me Sekretariatit EITI në Shqipëri. Po t'i referohemi termave përkatës, tek pjesa e tretë, aktivitetet dhe produktet, kemi vendosur realizimin e një spoti i cili do të

publikohet në televizionet kombëtare apo dhe lokale. Janë perzgjedhur tre televizione, një televizion kombëtar dhe 2 televizione lokale, ku kompania do të blejë kohën në media për të bërë të mundur kuptohet pas realizimit të spotit, transmetimin e këtyre spoteve në televizionet lokale dhe kombëtare. Në total do jenë tre aktivitete reklamuese në këto televizione. Një pike e rëndësishme që kemi menduar që do t'i shërbejë EITI-t meqë ka një veprimtari më shumë se 10 vjeçare, kemi menduar të realizojmë një dokumentar për aktivitetin e EITI-t, i cili do të jetë jo shumë i gjatë, diku te 15 minuta, ku kemi menduar që persona që kanë marrë pjesë në diskutimet e hershme të realizimit të Sekretariatit, ndërtimit të Sekretariatit, persona nga MSG-ja duke u fokusuar te shoqëria civile, do të japin kontributin e tyre përmes këtij dokumentari që do i shërbejë EITI-t edhe në vijim në aspektin historik, për të qenë le të themi ndoshta një ndër dokumentarët e parë, natyrisht me kalimin e kohës do të ketë dhe aktivitete të tjera pas shumë vitesh, por ky do të shërbejë si memorje fillestare historike për veprimtarinë e EITI-t, ku kontribues të ndryshëm, qoftë nga MSG-ja apo qoftë nga persona që e njohin veprimtarinë e EITI-t, të ndihmojnë sado pak me intervistat e tyre për të realizuar një dokumentar, për të treguar dhe punën që ka bërë EITI në një periudhë më shumë se 10 vjeçare. Një dokumentar i cili mund të perdoret më pas dhe nga mediat apo nga EITI ne vetvete, do të transmetohet në kanalet online që do të disponojë EITI në vijim për sa i përket veprimtarive që do të zhvillojë por kjo do të jetë një pikë e rëndësishme që do i shërbejë EITI-t dhe mendoj do i shërbejë dhe çdo personi që do ta prekë në mënyrë fillestare EITI-n për të kuptuar veprimtarinë që ky institucion ose më saktë jo vetëm ALBEITI si institucion, por dhe komponentët e rëndësishëm të këtij institucioni që janë MSG-ja apo institucione me të cilat në bashkëpunojmë, do të japin pikërisht rolin e tyre, kontributin e tyre që dhe njerëzit që e njohin EITI-n për herë të parë të kuptojnë si funksionon dhe veprimtarinë në vijim të EITI-t. Siç e thashë, ky dokumentar do të transmetohet në rrjetet sociale të Sekretariatit, por paralelisht dhe vete mediat e ndryshme në qoftë se do të ketë interes mundet ta transmetojnë. Kuptohet më pas kjo është një çështje për t'u diskutuar dhe me kompanitë e ndryshme mediatike gjithnjë në raport me interesin që ata kanë për të transmetuar informacione që lidhen me veprimtarinë me të cilën ne merremi. Një pikë tjetër e aktivitetit të medias është ndërtimi i kanaleve në rrjetet sociale, në rastin konkret ndërtimi i një kanali në Youtube, në LinkedIn dhe në Twitter. Janë platforma, të cilat të paktën në aspektin institucional te çështja e publikimit të videove apo të intervistave apo të veprimtarive, janë goxha të efektshme dhe koha ka treguar që janë platforma që përdoren botërisht nga institucionet serioze për sa i përket publikimit të aktiviteteve të tyre. Një element tjetër që kemi menduar është transmetimi i memeve në rrjetet sociale lidhur me veprimtarinë e EITI-t, do të realizojmë 10 meme konkretisht dhe gjithashtu hapësira e dedikuar për menaxhimin e rrjeteve sociale të Sekretariatit deri në nëntor të vitit 2025. Një element tjetër është përgatitja e broshurave informative për sa i përket aktivitetit EITI. Duke qenë se së fundmi letra është një element që sa vjen dhe nuk po përdoret më, kemi menduar të mos prodhojmë shumë të tilla.

**Znj. Ola Mitre:** Genci më fal për nderhyrjen, por meqenëse përmende pjesën e menaxhimit të rrjeteve sociale, aktualisht kush i menaxhon?

**Z. Genci Tërpo:** Aktualisht i menaxhoj unë rrjetet sociale.

**Znj. Ola Mitre:** E qarte, po më “shqetësojnë” këto postimet nga ministria, aktivitete që nuk e di ç'lidhje mund të kenë me EITI-n, pse duhet të jenë tek faqja e EITI-t? Cili është qëllimi që bëhen share këto lloj postimesh?

**Z. Genci Tërpo:** Ne jemi institucion që varem nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe natyrisht që marrim pjesë në aktivitetet e ndryshme që zhvillon ajo. Le të themi që kjo është një çështje e cila nuk



trajtohet vetëm nga institucioni ynë, janë shumë institucione në rastin konkret që promovojnë punën e institucioneve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nuk besoj se ka ndonjë problematike, të paktën në këtë periudhë zgjedhjesh, jemi munduar të përzgjedhim pikërisht aktivitetet që promovojnë punën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në qoftë se ministri ka një veprimtari të caktuar në fushën e energjisë së rinovueshme, apo të hidroenergjisë, apo projekteve të ndryshme që janë në fushën e industrisë nxjerrëse zhvillohen nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, natyrisht që është e mira që të gjithë ne të njihemi, sepse le të themi që jo të gjithë njerëzit që punojnë në një fushë të caktuar e njohin veprimtarinë e institucioneve të tjera që lidhen me Sekretariatit. E mira do të ishte që rrjetet sociale të shfrytëzohen, jo për publicitet të personave të caktuar, por për publicitet të aktiviteteve të ndryshme që zhvillojmë në të mirë të transparencës apo projekteve të ndryshme që ka qeveria për sa i përket çështjeve që lidhen me aktivitetin e Sekretariatit. Për shembull, në qoftë se unë do të merrja pjesë në takime të caktuara me ekspertë të institucionit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë apo të AKBN, apo të një institucioni tjetër çfarëdo, apo në qoftë se do të mendonim që këto aktivitete i shërbejnë transparencës apo punës, zhvillimit të legjislacionit apo projekteve që kanë të bëjnë me mundësitë në të ardhmen që mund të shqyrtohen dhe në aspektin e validimit të Shqipërisë, pavarësisht se ato janë në shqip, të paktën për ne le të jenë të nevojshme dhe të qarta për t'u njohur.

**Znj. Ola Mitre:** Nëse do të kishte lidhje me EITI-n do ta mirëkuptoja, por shpesh shoh aktivitete që nuk kanë asnjë lidhje me transparencën. Nëse e sheh këtë faqe duket si faqe e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë më tepër sesa e EITI-t.

**Z. Genci Tërpo:** Unë e shoh si faqe të EITI-t me thënë të drejtën, por nuk e di çfare problemi sjell publikimi i aktiviteteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në faqen e EITI-t.

**Znj. Ola Mitre:** Nejse, çështje këndvështrimi është.

**Z. Genci Tërpo:** Unë vura re një gjë. Që pjesa dërrmuese e anëtareve të MSG-së nuk janë fare pjesë e ndjekjes së kësaj faqeje. Megjithatë kjo nuk përbën problem.

**Znj. Ola Mitre:** Unë po flas për veten time, atë që shoh, sepse e ndjek. Ju nuk i ndiqni anëtarët e MSG-së?

**Z. Genci Tërpo:** Ajo duhet të jetë reciproke. Fillimisht duhet të na ndjekin anëtarët e MSG-së ne, që t'i ndjekim dhe ne ata, patjetër.

**Znj. Ola Mitre:** Personalisht e ndjek dhe më ka bërë përshtypje kjo gjë. Më duket pak e ekzagjeruar realisht, sepse duhet të jenë aktivitete që lidhen me fokusin tonë. Dikush e ndjek faqen për një interes të caktuar në lidhje me industrinë nxjerrëse dhe i del një postim për ujësjellësin, pra bie ndesh me misionin e faqes.

**Z. Genci Tërpo:** Dmth në qoftë se ministrja do të na postonte ne si EITI, do bënte politikë mendoni ju?

**Znj. Ola Mitre:** Ajo është tjetër gjë, ndoshta e ka për detyrë, ndërsa ne nuk e kemi për detyrë.

**Z. Lorenc Gordani:** Une personalisht, besoj që të gjithë e dini që ju ndjek dhe ju bëj share herë pas here. Jam dakord me çfare tha Ola, por do jua them shumë thjesht. Unë se kam problem, le të ndajnë rrjetet çfarë të duan. Na bezdis, s'na bezdis, ne nuk mund të vendosim për të tjerët. Unë propozoj të gjejmë një formë, që te Termat e Referencës të ketë dhe një rregullore etike, detyra funksionale etj, që personi që të merret mos t'jau leje dhe juve përgjegjësini, është një person që ka detyra specifike dhe sigurisht eviton atë që është e pashmangshme në Shqipëri, sepse ndoshta ai ato detyra ka dhe s'ka pse të ndjejë peshën e ndarjes së gjërave që janë jashtë fokusit të veprimtarisë së EITI-t.

**Z. Genci Tërpo:** Jemi duke diskutuar për diçka tjetër, po flasim për Termat e Referencës për aktivitetet e komunikimit. Ndërsa për sa i përket çështjes së menaxhimit të platformës, në rastin konkret është detyrë e Sekretariatit, pra është Sekretariati ai që e menaxhon platformën sociale, ashtu siç çdo institucion ka të drejtën për publikimin e çështjeve që lidhen me veprimtarinë e Sekretariatit apo dhe çështje të tjera të cilat ne mund t'i gjykojmë për sa i përket publikimit të tyre. Mendoj që të promovosh veprimtarinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë apo të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile që lidhen me veprimtarinë e EITI-t është e rëndësishme dhe në çdo moment ne kemi qenë të gatshëm, të paktën gjatë kohës që unë kam qenë në Sekretariat s'kemi patur ndonjë diskutim për të vendosur apo për të mos vendosur diçka në faqen e Sekretariatit. Përkundrazi, ne na shërben veprimtaria e institucioneve civile apo e grupeve të tjera të interesit për sa i përket çështjes së publikimit të tyre, por nga ana tjetër duhet të kuptojmë që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është institucioni epror i Sekretariatit në rastin konkret, kështu që të promovosh veprimtarinë e ministrisë për çështje të ndryshme që lidhen me zhvillimin e legjislacionit, apo me projekte të ndryshme, apo me strategji të caktuara nuk ndikon te pjesa e cënimit të EITI-t në vetvete. Megjithatë, pa diskutim, që nga ky moment e në vijim do të jemi edhe më të fokusuar në publikimin e atyre aktiviteteve që lidhen përgjithësisht me industrinë nxjerrëse apo me transparencën për sa i përket institucioneve të tjera jashtë EITI-t. Duhet të kuptohet që nuk ka asnjë lloj interesi për sa i përket çështjeve që lidhen me fushatën, të paktën askush nga Sekretariati apo nga sa kemi njohuri, nuk ka ndonjë aktivitet politik.

**Z. Dritan Dervishaj:** Genci më fal për ndërprerjen. Me duhet të largohem se kam një obligim/mbledhje tjetër për të cilin ju kam njoftuar dhe paraprakisht. Jam dakord me draftet në qoftë se do të bëhet ndonjë votim dhe për çdo gjë tjetër pastaj mund ta diskutojmë në mbledhjen e ardhshme. Kalofshi mirë!

**Z. Genci Tërpo:** Ok. Dakord. Që të mos na largohen të gjithë anëtarët e MSG-së se ndoshta do të zgjatet mbledhja pak më tepër, le të kalojmë tek ajo ç'ka unë lashë, pra pika 8 e aktiviteteve dhe materialeve që do të dorëzohen nga konsulenti, nga firma, nga kompania përkatëse. E lashë te prodhimi i broshurave informative për Sekretariatit. Kemi vendosur rreth 100 copë broshura informative, sepse kemi parë që magazinat e Sekretariatit janë mbushur me materiale, me broshura që kanë ngelur aty dhe tani ju ka ikur dhe koha. Kemi menduar që këto broshura të jenë dhe në formatin digjital, si një mundësi më e thjeshtë aksesimi për publikun. Natyrisht për interesa të caktuara që ne mund të kemi gjatë veprimtarisë EITI në takime, në konferenca, që mund të realizohen me një grup të caktuar njerëzish, kemi vendosur 100 broshura për sa i përket aktivitetit të Sekretariatit. Në qoftë se mendoni që duhet të shtojmë më tepër broshura në hard copy është një gjë që ne mund ta vendosim. Keni ndonjë mendim për sa i përket kësaj pjese? Pra mendoni që duhet të shtojmë më tepër broshura në hard copy?

**Znj. Anila Hajnaj:** Jo, s'ka nevojë.

**Z. Genci Tërpo:** Pra rreth 100 copë mendohet që janë mjaftueshëm. Të paktën këtë e kemi evidentuar dhe nga praktika, për shembull raportet me nga 300-400 faqe ne i kemi akoma në gjendje një pjesë të mirë të tyre. Ju kemi dërguar raporte institucioneve të ndryshme, bashkive të ndryshme, por janë ndoshta pak voluminoze dhe kemi menduar që të paktën letrën të fillojmë ta kursejme pak nga pak për të kaluar tek mënyra më e mirë për të aksesuar një informacion që është forma digjitale. Natyrisht që një pjesë të mirë të këtyre broshurave ne do t'i kemi atëherë kur do të jetë e nevojshme për t'ju bërë të mundur në tryezat e rrumbullakta pjesëmarrësve që të njihen me to. Por mendojmë që pjesa digjitale do të jetë më e favorshme dhe më e mirë. Te pika 9 kemi publikimin e 4 buletineve në format digjital për sa i përket aktiviteteve të EITI-t dhe kemi menduar që në këto buletine të përfshijmë dhe veprimtarinë e organizatave të shoqërisë

civile apo grupeve të tjera të interesit që janë pjesë e MSG-së dhe në vijim unë do t'ju ftoja dhe juve që aktivitetet tuaja që janë të rëndësishme të jenë pjesë e këtyre buletineve, sepse në njëfarë forme edhe ne na shërbejnë që të promovojmë përmes Sekretariatit punën e MSG-së, punën e anëtarëve të MSG-së, apo të organizatave, apo institucioneve që ju drejtoni, sepse kjo i shërben transparencës dhe ndikon jashtëzakonisht shumë dhe në proceset e ndryshme që do të këtë EITI në vijim duke përfshirë validimin apo njohjen e publikut me gamën e gjerë që mbulon EITI, sepse EITI nuk është vetëm kjo zyrë EITI jeni edhe ju. Pra aktivitetet tuaja mendojmë që duhet të jenë pjesë e buletineve. Në vijim kur këto aktivitete të fillojnë do ishte e mira të mblidhemi, të pakten shoqëria civile, apo edhe pjesa e anëtarëve të MSG-së të promovojnë punën e tyre përmes shkrimeve të aktiviteteve në këto 4 buletine për periudhën 2023-2025. Një pikë tjetër është transmetimi i videove reklamuese në digital boards, që do të zhvillohet për një periudhë 1 mujore. Kalojmë te dy pjesë që janë shumë të rëndësishme, organizimi i konferencave, tryezave të rrumbullakta me një numër të paktën rreth 50 persona ku kompania do ta lehtësojë të gjithë veprimtarinë për sa i përket akomodimit në salla të caktuara, përgatitjes së ftesave, organizimit dhe arrenxhimit të eventit, sallës, coffee break, apo drekën, laptopin, projektorin, axhendat. Pra të gjithë elementët e nevojshëm për të zhvilluar konferencën dhe paralelisht e njëjta gjë është dhe për tre takime me stakeholders apo grupet e interesit. Do të përzgjidhen pikërisht tre rajone që kanë aktivitet në fushën e industrisë nxjerrëse me të njëjtët komponentë që kemi përmendur dhe më sipër. Të gjitha këto aktivitete do të zhvillohen për periudhën 2023-2025. Natyrisht që do të kërkohet patjetër pjesëmarrja e anëtarëve të MSG-së në këto takime, sepse roli i MSG-së është shumë i rëndësishëm për të promovuar, qoftë veprimtarinë e EITI-t, qoftë punën e anëtarëve të MSG-së për sa i përket çështjeve që lidhen me EITI-n. Pra këto janë aktivitetet që do të realizohen për një periudhë 2 vjeçare nga kompania e caktuar për të lehtësuar veprimtarinë e EITI-t dhe natyrisht që një pikë e rëndësishme do të jëtë dhe çështja e krijimit të kushteve të favorshme për ekzistencën e kanaleve digjitale Youtube, Facebook, të cilin aktualisht e kemi dhe për sponsorizimin e këtyre kanaleve për të qenë sa më afër me publikun. Nga praktika që patëm në vitin 2020, me sponsorizimet që bëmë, pamë një impakt të jashtëzakonshëm të veprimtarive të EITI-t në aspektin e prekjës së qytetarëve, apo persona të caktuar filluan të shprehin interes. Jemi fokusuar shumë më tepër te pjesa digjitale si një nga mekanizmat kryesorë që po përdoret tashmë për të shkuar më afër publikut dhe institucionet, me këdo që ka interes për t'u njohur me veprimtarinë dhe punën e Sekretariatit. Do të jëtë një punë goxha e gjatë, do ta mbajë lidhur goxha kompaninë që do të operojë në këtë lloj fushe, sepse do të jëtë, jo vetëm një lehtësues për realizimin e këtyre aktiviteteve, por do të shërbejë dhe si një konsulent i caktuar për të ndihmuar EITI-n në promovimin e punës duke pasqyruar të gjitha materialet publicistike në kohë dhe me cilësi për të garantuar veprimtarinë e institucionit dhe organizmave brenda tij që të kenë mundësi të transmetojnë punën e tyre me një gamë më të gjerë përmes një institucioni siç është Sekretariati. Unë kaq kisha për këtë pjesë. Keni ndonjë mendim, ndonjë koment?

**Z. Lorenc Gordani:** Mundësia e përgatitjes së kartëvizitave për anëtarët e bordit është e parashikuar apo është diçka që s'ka qenë si praktikë?

**Z. Genci Tërpo:** Besoj do të mundemi ta zgjidhim këtë lloj problemi. Kur të bëjmë kartëvizitat këtu, do të bëjmë të mundur përfshirjen e kartëvizitave dhe për anëtarët e MSG. Mjafton të na njoftoni kush ka nevojë. Nuk besoj se ka ndonjë kosto të madhe, mendoj se zgjidhet, nuk ka ndonjë problem për këtë pjesë.

**Z. Lorenc Gordani:** Kostoja varet dhe nga sasia që do të përgatitet, po në rastin më të keq është rreth 1000 lekë të reja deri në 60 copë që është sasia më e vogël.

**Z. Genci Terpo:** Pa problem, mendoj që është një gjë që zgjidhet. Dmth kur të jemi ne momentin e bërjes së kartëvizitave, patjetër që do ju themi të na dergoni të dhënat e sakta që t'ju bëjmë dhe juve, kush ka nevojë.

**Z. Lorenc Gordani:** Faleminderit.

**Znj. Anila Hajnaj:** Po menaxhimin e këtyre rrjeteve të komunikimit kompania do ta mirëmbajë apo do të kryhet prej jush?

**Z. Genci Terpo:** Ne për momentin nuk është se kemi një person, sepse ai që i menaxhonte nuk është më pjesë e Sekretariatit, për rrjedhojë do të jëtë një person në vijim, besoj pas 1-2 muajsh, patjetër që do të kemi një person që do të merret me këtë çështje që do të jëtë pjesë e stafit të Sekretariatit. Për sa i përket publikimit do të jetë EITI ai që do të japë konfirmimin, ndërsa hedhja e tyre në sistem mund të bëhet nga kompania, por pjesa e menaxhimit në përgatitjen e materialeve do të jetë detyrë e Sekretariatit. Publikimi i tyre është një gjë që besoj bëhet dhe nga kompania bëhet dhe nga ne, do të jetë e dyanshme, pa problem.

**Znj. Anila Hajnaj:** Përse kur kërkohet në internet del Sekretariati dhe jo ALBEITI. Ka marrë një si lloj pornësie të EITI-t Sekretariati.

**Z. Genci Terpo:** Është vënë Sekretariati pasi dhe vendimi i Këshillit të Ministrave për ngritjen e Sekretariatit përmend "Sekretariati" dhe ne kemi qenë të detyruar të vendosim këtë emërtesë të gjatë, por natyrisht mund të vendosim ALBEITI dhe në kllapa Sekretariati. Pra e gjejmë mënyrën për ta vënë ALBEITI si element kryesor.

**Znj. Emiliana Kola:** Anila, ti ke të drejtë për këtë që thua, por duhet të kemi parasysh që ne jemi një institucion që menaxhohet nga AKKSH-i gjë që e komplikon pak situatën për pjesën e shfaqjes kur bëhet search thjesht ALBEITI dhe jo Sekretariati.

**Znj. Anila Hajnaj:** ALBEITI është me vendim qeveritar. Sekretariati është në funksion të ALBEITI-t faktikisht.

**Z. Genci Terpo:** Për sa i përket aktiviteteve jeni ok? Mendoni se duhet të shtojmë ndonjë gjë? Siç thashë koha ka treguar që hard copy nuk është shumë e domosdoshme, në krahsim me pjesën digjitale.

**Znj. Anila Hajnaj:** Keni shumë të drejtë. Jam dakord.

**Z. Genci Terpo:** Gjithashu edhe këtë pjesën e banerave mund ta përdorim. S'kemi vendosur vite për fat të mirë, kështu që kemi gjithë kohën në dispozicion për t'i përgatitur këto materiale që varen në mur dhe promovojnë veprimtarinë e EITI-t. Pra këto mund të perdoren edhe nga ju nëse keni aktivitete të caktuara që i referohen çështjes së EITI-t.

**Znj. Anila Hajnaj:** Ju falenderoj për këtë.

**Z. Genci Terpo:** Për ne dokumentari është i rëndësishëm, sepse do të ketë informacion shumë të qartë dhe të thjeshtë për sa i përket veprimtarisë së EITI-t duke ndihmuar kështu ata që njihen për herë të parë me EITI-n. Nga ana tjetër buletinet do të pasqyrojnë aktivitetet që do të zhvillojmë gjatë kësaj periudhe 2 vjeçare. Të dy këta elementë do të mbeten në historinë e EITI-t.

**Znj. Anila Hajnaj:** Une kur fola për konsulentin faktikisht e kisha për konsulentin e komunikimit dhe pavarësisht së kjo është një kompani profesionale për çështjet e komunikimit, ashtu siç e përmenda dhe më parë çështjet e EITI-t janë shumë specifike dhe unë mendoj se duhet të futen dhe konsulentë nga grupi i MSG-së pra t'i imponohet kompanisë që të marrin me patjetër konsulentë nga MSG-ja, nga shoqëria civile, si dhe nga juve. Nëse nuk bëhet një gjë e tillë, produkti do të jetë diçka vizuale pa kontent.

**Z. Genci Terpo:** Duhet të kemi parasysh që kompania ka për detyrë të punojë atë ç'ka ne japim, ç'ka ne ofrojmë ajo ta prodhojë. Pra në qoftë se bëhet dokumentari dhe do të intervistohet Anila, Mariola, Genci,

Bilali, Samiu, natyrisht që ajo do të vendoset brenda dokumentarit. Ne thjesht japim produktin, pastaj pjesa vizuale është detyrë e kompanisë për ta realizuar. Kompania nuk ka rol për të bërë politika. Kompania ka rol për të publikuar atë ç'ka ne i themi. Në vijim ne mund të diskutojmë me Bankën për të garantuar mundësinë e një financim specifik për të qenë një person i dubluar, pra le ta ketë EITI atë specialistin e komunikimit që merret me këtë punë, por paralelisht mund të prokurohet në të ardhmen, pra brenda këtij viti, dhe një konsulent i caktuar me njohuri specifike në fushën e gazetarisë apo shoqërisë civile që lidhet ngushtë me çështjet e medias për të bërë të mundur që këto materiale ku promovohen aktivitete të ndryshme, të cilat ne mund t'ja japim ose ai vetë mund t'i realizojë në bashkëpunim dhe me ju, të dalin në platformat sociale të EITI-t. Por kompania në vetvete do bëjë vetëm një produkt. Pra ne e japim ai e prodhon, nuk bën pjesën e politikave.

**Znj. Emiliana Kola:** Atëherë Anila, këtë diskutim e kemi bërë ndër vite dhe nuk është e mundur, sepse është konflikt interesi që të përfshihen anëtarët e MSG-së drejtpërdrejt për aktivitetet që financohen nga Banka, sepse praktikisht jeni juve që miratoni Termat e Referencës dhe është konflikt i hapur interesi. Është një diskutim që është bërë ndër vite, që ti e mban mend dhe Samiu besoj, se të tjerët kanë ardhur më vonë. Ne nuk na lejohet, nuk mund ta bëjmë këtë gjë në këtë lloj mënyre si e shprehe ti, sepse ju miratoni termat nuk mund të jeni dhe pjesë e stafit të prokurimit.

**Znj. Anila Hajnaj:** Unë e di shumë mirë këtë gjë dhe ne e kemi diskutuar edhe me zëvendësministrin. Duhet gjetur mekanizma brenda kompanisë nga shoqëria civile, mund të mos jem unë personalisht, po ka persona në institucionet e Samiut, Mariolës që merren me këtë gjë, janë në fushën e gazetarisë. Ju e dini shumë mirë përplasjen që pata unë me juristen që u mor me atë projektin për çështjet sociale, që nuk e kishte idenë se çfarë është EITI. Ne jemi përballur me këto situata.

**Znj. Emiliana Kola:** Duke qenë se juve miratoni termat është e pamundur, është konflikt i pastër interesi, ndërsa për sa i përket aktivitetit të mjedisit ajo ishte specifike që kishte të bënte me mjedisin nuk ishte detyrim që kompania të kishte njohuri për EITI-n dhe njohuritë duhet të ishin për mjedisin. Është tjetër gjë administratori i pavarur që duhet të ketë eksperiencë dhe duhet të njohë standardin EITI.

**Znj. Anila Hajnaj:** Nga organizatat tona ne kemi ekspertë që e njohin EITI-n dhe do i vijmë në ndihmë. Pa ne si individë.

**Znj. Emiliana Kola:** E kuptoj Anila, por a nuk je pjesë e MSG-së si organizatë?

**Znj. Anila Hajnaj:** Unë jam anëtare e një organizate, por këtu jam personalisht, me emër individual, jo si organizatë. Të gjithë këtu jemi personalisht.

**Z. Genci Tërpo:** Mesa po kuptoj unë po flasim për diçka të ndryshme nga termat. Kompania që do ta zhvillojë këtë lloj projekti ka një numër të caktuar punonjësish, ekspertësh. Për momentin nuk e dimë cila kompani është, por ajo operon në një fushë specifike që është aktiviteti publicistik, ndërtimi i rrjeteve, i spoteve, i dokumentarëve, pra po flasim për një kompani që merr përsipër të bëjë atë ç'ka ne i themi, pra ne japim produktin, ai prodhon atë që ne kërkojmë. Në rastin konkret kur të bëhet spoti padiskutim që jemi të gatshëm të pranojmë çdo mendim tuajin për spotin në fjalë, në një mbledhje të caktuar ose dhe në takime, zyrat tona i keni të hapura gjithmonë. Spotet kanë një kosto të madhe transmetimi, prandaj do përzgjedhim që në 30 sekonda të themi ato gjëra që janë të rëndësishme. Jemi të ftuar në çdo lloj aktiviteti që lidhet me përgatitjen e produktit për transmetim. Pra kompania është një ekzekutues, ekzekuton çfarë i themi ne dhe ju jeni pjesë e këtyre produkteve. Mund ta bëjmë dhe kështu. Një buletin i caktuar të jetë personal për organizatat e shoqërisë civile, për punën tuaj, ç'keni bërë e ç'do të bëni, intervistat tuaja, promovimi juaj për sa i përket punës suaj. Për ne s'përbën problem, mund të zgjedhim dhe më shumë

buletine. Për ne është e rëndësishme që veprimtaria e EITI-t të transmetohet dhe kjo është një mundësi shumë e mirë për t'i dhënë akses çdo personi që kontribuon në EITI, të promovojë punën e tij. Ju jeni detyrimisht konsulentë të kësaj gjëje, por kompania është një ekzekutor, siç i themi ne e bën, s'na pëlqen diçka e ndryshojmë, çdo gjë që del aty është produkt i joni, ata thjesht prodhojnë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Jam dakord me këto propozimet tuaja, më pëlqejnë, por gjithmonë i referohem, sepse kam pasur shqetësime për dy projektet që u bënë më parë. Pretendonin që ishin organizata të mirëfillta, që kishin background, por rezultoi që nuk kishin fare njohuri. EITI është shumë specifik dhe çështja e mjedisit është specifike. Po të shohësh materiale që ka bërë Ola për mjedisin janë shumë specifike. Janë shumë më të vlefshme seç ka patur ai studim. Prandaj i kushtoj rëndësi kësaj gjëje. Mund të them që jam bërë eksperte e EITI-t pas kaq shumë vitesh. Edhe ju po ashtu.

**Z. Genci Tërpo:** Jam shumë dakord me ç'ka po thua, por kompania s'ka lidhje me këtë pjesë. Bën punën për të cilën paguhet.

**Znj. Ola Mitre:** Normalisht kompania e bën më mirë punën nëse e njeh si proces, njeh termat, njeh konceptet dhe di ç'të përfshijë ne spot apo dokumentar. Ne kemi parë shumë gabime në rentë minerare për sa i përket datave. Kompania duhet të ketë njohuri që të mos i kapim ne gabimet rrugës.

**Z. Genci Tërpo:** Po flasim për dy gjëra të ndryshme. Supozojmë se unë kam një kompani publicistike dhe jam personi që po e marr përsipër këtv punë. Unë pres që të më japësh ti material, sepse je ti ai që më udhëzon mua dhe më jep të dhënat e sakta për atë ç'ka do të transmetosh. Pra kjo është puna e kompanisë.

**Znj. Ola Mitre:** Edhe për Facebook duhet të ketë disa terma në statuse që të mos dalin jashtë kontekstit.

**Z. Genci Tërpo:** Po, sigurisht. Çdonjëri këtu mendoj që ka një background. Unë personalisht kam diku te 10 vite eksperiencë në fushën e shoqërisë civile. Nga viti 2000 deri në 2010 kam punuar në institucionet e shoqërisë civile me projekte nga më të ndryshmet, që lidheshin me çështjen e të drejtave të njeriut dhe mbuloja një fushë të caktuar, që ishte dhe pjesa mediatike. Pra 10 vite më kanë shërbyer për të kuptuar se si duhet të transmetosh informacion tek ata të cilët mund të kenë shumë informacion, por dhe tek ata që s'kanë fare informacion, pra për të qenë sa më afër publikut. Kjo s'është detyra ime sot, por unë pa problem mund ta bëj këtë. Por siç ju thashë, ju do të jeni pjesë e këtyre produkteve. Për shembull, marr rastin e buletinit që do tv ketë informacione në lidhje me punën tuaj. Materialet tuaja do i përcillen kompanisë, ju do e shkruani vetë, siç e mendoni dhe kompania do ta prodhojë. Është një makineri, që ne i japim produktin, ajo të sjell konsumin.

**Znj. Anila Hajnaj:** Por po t'ja japim të gatshme kompanisë, do të thotë që ajo do i postojë në rrjetet sociale dhe do të paguhet për këtë.

**Z. Genci Tërpo:** Po kjo është puna e kompanisë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Pra kompania do të marrë gjithë ato para që të prodhojë atë që ne prodhojmë. Do punojmë të gjithë neve që ata të marrin para. S'është e drejtë.

**Z. Genci Tërpo:** Po këtë punë kemi bërë gjithnjë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Ata duhet të jenë ekspertë dhe të prodhojnë vetë dhe ne t'i kontrollojmë dhe t'ju themi ku e kanë gabim. Asnjëri nga ju nuk paguhet për t'i prodhuar këto materiale që të paguhet ai tjetri, apo jo?

**Z. Genci Tërpo:** Duke marrë parasysh aktivitetin para 3 vitesh, ka qenë një formë e ngjashme me aktivitetin që kemi aktualisht. U prodhua baneri, spoti, broshura.

**Znj. Anila Hajnaj:** Kush i prodhoi?

**Z. Genci Tërpo:** Kompania përkatëse.

**Znj. Anila Hajnaj:** Dakord për pjesën e dizajnit, po kontentin kush e prodhoi?

**Z. Genci Tërpo:** Po kontentin sigurisht që do e jap unë, s'mund të shkruajë kompania për punën time. Të siguroj që të gjitha kompanitë që merren me këtë punë janë ekspertë, por ajo që dua unë, ajo që doni juve, ajo do dalë aty, jo ajo që do kompania. Se i bie të ikim në të gjithë që këtu, t'i themi kompanisë hajde, t'i zhbëjmë gjithë politikat.

**Znj. Anila Hajnaj:** Nuk flasim për politikat. Dizajnin sigurisht që do e bëjnë ata. Nuk flasim për këtë element. Buletinet do t'i hartojmë ne, pjesën e shoqërisë civile, ose gjërat e tjera ju dhe do t'i kontrollojmë ne, dakord. Por do të bëhen xhirime në qoftë se ne do të bëjmë një dokumentar, duhet të jetë dikush që është ekspert, se dhe këndi i vështrimit ka rëndësi.

**Z. Genci Tërpo:** Unë nuk jam ekspert xhirimesh. Mendoj që pjesa më e madhe e jona nuk janë. Dhe ndaj po marrim një kompani që disponon të gjitha mjetet, kushtet, ka aktivitet në këtë lloj fushe, se s'do marrim një kompani që u krijua sot.

**Znj. Anila Hajnaj:** Po nuk ka kompani që kanë aktivitet për EITI-n.

**Z. Genci Tërpo:** Nuk po flasim për aktivitete të EITI-t. Po flasim për aktivitete të fushës për realizimin e këtyre gjërave. Cila kompani xhirimesh, mediatike ka aktivitet për ujërat? Asnjëra, por ato dinë konceptet se si bëhet një xhirim, këndi, drita, vendi, pra nuk është detyra jonë ta zgjidhim këtë punë, e zgjidh kompania. Detyra jonë është t'i themi kompanisë që do të nxjerrë aktivitetin e Gencit, Emilianës, Mariolës, që ka të bëjë me fushën EITI dhe mendoj që secili prej nesh, për të realizuar një material të caktuar, i gjen 10 minuta kohë në qoftë se do. Në qoftë se s'do, ska problem se e bën Sekretariati këtë pjesë. Çdonjëri prej nesh mund të tregojë kontributin e vet. Por e theksoj, kompania nuk ka lidhje me bërjen e materialeve. Kompania e bën këtë material, sot ka ekspertë sa të duash, por s'jau japim kompanisë autorësinë e bërjes së kontentit, pasi është e jona. Autorësia e produktit është e kompanisë. Pra materiali, brendia është produkt i joni, sepse kjo është detyra jonë në fund të fundit. Në qoftë se s'i bën MSG-ja, s'ka problem se i bëjmë ne.

**Znj. Anila Hajnaj:** Normal, i kemi bërë dhe do i bëjmë nuk diskutohet. Për të mos harxhuar kohë duhet të merret parasysh që të jenë pak ekspertë.

**Z. Genci Tërpo:** Sigurisht që kompania që do të merret me këtë punë do të ketë ekspertë, por që të rikthehemi se po flasim për një gjë tjetër. Për sa i përket termave dhe aktiviteteve që do të realizohen, se e lamë në këtë pikë, jemi dakord?

**Znj. Anila Hajnaj:** Unë dakord jam.

**Znj. Mariola Kito:** Po, dakord jam.

**Z. Lorenc Gordani:** Po, dakord.

**Z. Bilal Koçi:** Po, dakord.

**Z. Genci Tërpo:** Ok, më poshtë kemi dhe një element për kualifikimin. Kemi vendosur minimalisht 5 vite aktivitet të këtyre kompanive në pjesën e organizimit të eventeve, në dizajn, në fushata kreative, në promovim të aktiviteteve të komunikimit në platformat sociale, në media, në graphic design, layout dhe në ekzekutimin e spoteve televizive dhe programeve vizuale, si dhe të kenë mundësisht në CV-në e tyre veprimtari në fushën e EITI-t, pra të kenë një njohje të caktuar që do të na e provojnë me dokumente. Pra jemi dakord për sa i përket kësaj pjese?

**Znj. Anila Hajnaj:** Ok.

**Znj. Mariola Kito:** Ok. Është parashikuar që për kompaninë që selektohet të bëhet një trajnim që të marrë sa më shumë informacion për sa i përket aktiviteteve EITI, që të jenë më tepër në brendësi, apo ne të sigurohemi që kompania, nëse nuk ka pasur, ka tanimë informacionin e duhur brenda limiteve të ushtrimit

të aktiviteteve?

**Z. Genci Tërpo:** Ne kemi vendosur që të ketë aktivitete në fushën EITI si një kriter preferencial. Mund të ndodhë dhe kjo, patjetër. Besoj që ne jemi të gatshëm bashkë me ju që të ulemi dhe të flasim me ta për çështjen eiti. Mendoj që është një element që ne e kemi në dorë vetë. Sigurisht që nëse ju e gjeni kohën. Ne gjithmonë kemi kohë se me këtë punë merremi në fund të fundit. Po marr rastin e dokumentarit. Mendoj që dikush nga ju ose disa nga personat që operojnë në fushën e shoqërisë civile të MSG-ja duhet të jenë patjetër pjesë e dhënies së intervistave për dokumentarin, sepse ju jeni pjesa historike e Sekretariatit për sa i përket çështjes që mbulon MSG-ja dhe ajo ç'ka ju do të transmetoni te puna e realizimit të dokumentarit ka për të mbetur si një gur themeli për vijueshmërinë e EITI-t, në mënyrë që të gjithë bashkë, ju, unë, Sekretariati, personat që kanë qenë pjesë e EITI-t që në fillim, funksionarë të caktuar, mund të jenë pjesë e këtij dokumentari. Në lidhje me dhënien e infos, se nuk mund t'i trajnojmë, ne jemi të gatshëm, por dhe ju besoj jeni të disponueshëm që të jepni kontributin tuaj për këtë pjesë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Ideja e dokumentarit është shumë e bukur dhe mua më pëlqen shumë, por duhet një skenar. Kush do ta bëjë skenarin?

**Z. Genci Tërpo:** Kompania.

**Znj. Anila Hajnaj:** Prandaj them që kompania duhet të ketë një ekspert nga ne.

**Z. Genci Tërpo:** Kush tha që kompanitë nuk e kanë ekspertin?

**Znj. Anila Hajnaj:** Ekspert për EITI-n e kam fjalën.

**Z. Genci Tërpo:** Po ndoshta e kanë ekspertin. Prandaj them të ulemi dhe të japim kontributin tonë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Unë jam e gatshme të jap kontributin tim, se dhe formimin e kam, jam e trajnuar për communications. Por nuk e kemi gjithë kohës detyrim vullnetar. Duhet të jetë pak e menduar kjo punë. Siç thashë, unë parvjet kam hasur shumë vështirësi me kompaninë. Jua kam shpjeguar veprimtarinë e EITI-t dhe ata nuk e përvetësuan informacionin edhe pasi mbaroi projekti.

**Z. Genci Tërpo:** E kuptoj. Mesa mbaj mend kanë qenë dy kompani të ndryshme që kanë bërë ato dy projektet. Në njerën prej tyre ka qenë ABCons me Michael Barron, i cili konsiderohet si guru i EITI-t, nga ekspertët ndërkombëtar. Pra ai e njih EITI-n dhe këtë e vërteton dhe CV-ja e tij. Se sa ishte produkti i asaj që ne kërkonim, këtë nuk di ta them, por di që u përdor nga Sekretariati Ndërkombëtar si një çështje e rëndësishme. Siç tha dhe Emiliana, njëri kishte të bënte me impaktin social dhe tjetri me mjedisin. Pra pa ju futur kësaj gjëje, natyrisht në vijim ne do të kemi dhe gjëra të ngjashme që zhvillojnë çështjen në fushën EITI dhe sigurisht që aty do të kemi dhe çështje të tjera për të diskutuar. Unë e kam të nevojshme prezencën tuaj në vijim, dhe jo vetëm përmes platformave, po dhe fizikisht. Edhe zëvendësministri, në diskutimet që kemi bërë, ka qenë i gatshëm për të zhvilluar takime dhe në ambientet e ministrisë, pra mbledhjet e MSG-së të jenë dhe fizikisht, jo vetem online, paçka vështirësisë që mund të na krijojë kjo gjë. Mund të lemë ndonjë mbledhje në axhendën tuaj për të diskutuar, sepse kjo na ndihmon, na afron pak më tepër me njëri-tjetrin, jo se s'jemi të afërt absolutisht.

**Znj. Ola Mitre:** Këtë diskutimin për pjesën e strategjisë së komunikimit mos gaboj e kemi bërë dhe vjet ose parvjet, kemi kaluar ca ToRs, por nuk jam në dijeni çfarë ndodhi me procedurën e mëparshme, është zgjedhur ndonjë kompani? A janë miratuar të gjitha procedurat që do të ndiqeshin?

**Znj. Emiliana Kola:** E ka fjalën për strategjinë e komunikimit.

**Z. Genci Tërpo:** Ne e zhvilluam atë si projekt.

**Znj. Ola Mitre:** Dmth u zhvillua projekti dhe transparenca zero. U bënë dhe aktivitete.

**Znj. Emiliana Kola:** Jo, nuk janë bërë aktivitete për strategjinë e komunikimit. Nuk është fushata e



komunikimit. Thjesht hartimi i dokumentit dhe strategjia përfundimtare ju është nisur juve për të dhënë konfirmimin final.

**Z. Genci Tërpo:** Unë në orën 13:00 kam një tjetër videokonferencë me EITI-n ndërkombëtar. Jemi dakord për termat, t'i konsiderojmë të miratuar?

**Z. Bilal Koci:** Dakord.

**Znj. Anila Hajnaj:** Ok.

**Z. Lorenc Gordani:** Dakord.

**Znj. Mariola Kito:** Dakord.

**Z. Genci Tërpo:** Ju falenderoj! E zgjatëm shumë sot, por mendoj që na bëri mirë, sepse diskutuam çështje që na shqetësonin. Ju falenderoj për kontributin. Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe ju uroj punë të mbarë. Mirupafshim!

**Mbledhja zgjati: 01:42:32**